



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 410/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vehbi Imeri nga radhët e koalicionit LDK-AKR, paraqitur kundër vendimit për rezultatin përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vehbi Imeri nga koalicioni LDK-AKR,

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatit për deputet nga koalicioni LDK-AKR në Vendvotimet 1323E/02R, 1307E/07D, 1305E/01R, 1303E/02R, 1324E/02D, 1309E/01D, 1307E/01R, 1307E/02R, 1307E/03R, 1307E/04R, 1307E/05R, 1307E/06R, 1322E/01R, 1322E/02R, 1322E/03D, 1317E/01R, 1317/02R, 1317/03R, 1317/04D, 2403A/01R, 2403A/02R, 2403A/03R, 2403A/04R, 2403A/05R, 2403A/06D, 2414A/01R, 2414A/02R, 241A/03D, 2406A/02D, 2531D/01R, 2531D/02D, 2532D/01R, 2532D/02D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit në Venvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.06.2017, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vehbi Imeri, nga radhët e koalicionit LDK-AKR, me të cilën pretendon se në Vendvotimet 1323E/02R, 1307E/07D, 1305E/01R, 1303E/02R, 1324E/02D, 1309E/01D, 1307E/01R, 1307E/02R, 1307E/03R, 1307E/04R, 1307E/05R, 1307E/06R, 1322E/01R, 1322E/02R, 1322E/03D, 1317E/01R, 1317/02R, 1317/03R, 1317/04D, 2403A/01R, 2403A/02R, 2403A/03R, 2403A/04R, 2403A/05R, 2403A/06D, 2414A/01R, 2414A/02R, 241A/03D, 2406A/02D, 2531D/01R, 2531D/02D, 2532D/01R, 2532D/02D

nga rezultati përfundimtar i publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, i mungojnë votat në vendvotimet e lartëcekura si në komunën e Lipjan, Ferizaj Suharekë, Fushë Kosovë, Pejë dhe Prishtinë.

Parashtruesi i ankesës pretendon se në tërësi iu kanë manipuluar 1200 vota në tërë territorin e Kosovës, dhe kërkon që të bëhet rinumërimi votave të këtij VV.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e provës si dëshmi ka bashkangjitur kopjen e FRK-së për vendvotimin 2521/D01D, në të cilin pretendon se ka pasur parregullsi dhe deklaratën e anëtarit të KVV-së të po të njejtit VV.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

Paneli ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe pas hetimit të materialit zgjedhor si dhe hetimit të bërë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), në 5 kuti: 1323E/02R, 1307E/07D, 1305E/01R, 1303E/03R dhe 1324E/02D gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara.

Nga hetimi i bërë rezulton se kandidati me nr. 106, Vehbi Imeri nga radhët e subjektit politik Koalicioni LDK-AKR në komuna e Lipjanit, në VV 1327e/02R në FRK- ka poseduar 211 vota. Paneli pas rinumërimit në QNR në të njëjtën VV ka gjetur se kandidati me nr. 106, Vehbi Imeri posedon 214 vota.

Andaj, paneli duke u nisur nga gjendja e vërtetuar faktike konstatoj se pretendimet në ankesë janë të bazuara dhe nuk vazhdoj me hapjen e kutive tjerë dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron KQZ-ja, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit të vendimit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 410/2017 më datën 02.07.2017.



Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.